



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

PROGRAMI I LËNDËS
Drejtimi : Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore

TITULLI I LËNDËS: ETNOMUZIKOLOGJI

Pedagogu: Akademik, Prof. Dr. Vasil S. TOLE
Ngarkesa: 4 ECTS (30 leksione dhe 15 seminare)
Lloji i lëndës: lëndë me zgjedhje
Programi i studimit: Bachelor
Viti/Semestri: I/II

EKSTRAKT

Krijimi i muzikologjisë dhe etnomuzikologjisë si shkencë, në Shqipëri u bë i mundur pas Luftës së Dytë Botërore megjithëse etnomuzikologjia në botë vite që ishte krijuar. Për kujtesë, si një aktivitet i llojit akademik, muzikologjia e krahasuar, ashtu si muzikologjia historike, ka një histori gati 100 vjeçare, duke marrë si kufi fillestar publikimin e studiuesit vjenez Guido Adler (1855-1942), “*The Scope, Method, and Aim of Musicology*” (1885). Adler ishte i pari që ndër të tjera radhiti studimin krahasues të muzikës jo perëndimore, si një ndarje e muzikologjisë sistematike, së bashku me teorinë e muzikës, estetikën dhe psikologjinë e muzikës. Kërkimet shkencore për muzikën jo perëndimore u bënë të mundura edhe nga dy risi teknike të fundit të shek. XIX: *shpikja e gramafonit në vitin 1877 nga shkencëtari amerikan T. Edison (1847-1931) si dhe nga zhvillimi i sistemit të matjes së lartësisë së tingullit më 1885 nga fizikanti dhe fonetisti anglez A.J. Ellis etj.*

Lënda do të fokusohet në dy drejtime : së pari në njohjen e parimeve të shkencës së etnomuzikologjisë dhe së dyti, në realitetin etnomuzikologjik shqiptar. Në Shqipëri dhe Kosovë, ka pasur interesime për folklorin dhe traditat shqiptare nga këndvështrime të ndryshme, këto të paraprirra nga vëzhgimet dhe shënimet e udhëtarëve të cilët i kanë vizituar ato, në kohë të ndryshme. Ky interesim është shfaqur si për kulturën muzikore iso-polifonike në Jug të Shqipërisë, ashtu edhe për kulturën muzikore monodike në veri të saj. Pavarësisht krimit të shkencës etnomuzikologjike shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore, duhet të pranojmë se ka ekzistuar një literaturë e cila ndonëse anësisht, ka prekur dhe ekspoloruar terrenin e trashëgimisë kulturore shqiptare: *materiale dhe shpirtërore.*

TEMAT:

Etnomuzikologjia në botë:

LEKSION 1. Cështë etnomuzikologjia.

LEKSION 2. Fillesat e etnomuzikologjisë si shkencë.

LEKSION 3. Etnomuzikologjia pas Luftës së II-të Botërore.

LEKSION 4. Parimet e punës etnomuzikologjike në terren.

LEKSION 5. Fazat e punës në terren

LEKSION 6. Sistemet muzikore, stilet dhe tipet.

LEKSION 7. Analiza krahasuese e stileve

LEKSION 8. Etnografia në muzikë

Etnomuzikologjia në Shqipëri:

LEKSION 9. Interesimet për mbledhjen e folklorit të muzikës popullore shqiptare dhe të fjalësit të saj- iso-polifonia dhe monodia.

LEKSION 10. Fillesat e punimeve muzikologjike shqiptare

LEKSION 11. Regjistrimet diskografike : filmat me objekt muzikën popullore;ekspeditat e huaja për mbledhjen e folklorit muzikor;

LEKSION 12. Themelimi i institucioneve të specializuara të etnomuzikologjisë. Prof. Ramadan Sokoli themelues i etnomuzikologjisë shqiptare

LEKSION 13. Harta etnomuzikore, makrostrukturë e trashëgimisë kulturore shpirtërore.

LEKSION 14. ISO-POLIFONIA-shumëzërëshi i Shqipërisë së Jugut.

LEKSION 15. Një zërëshi-i Shqipërisë së Veriut

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI:

70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)
Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)
25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)
20 % e notës përfundimtare

KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri
40 % e notës përfundimtare

DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të smestrit)

LITERATURA:

1. Vasil S. Tole, « Hyrje në etnomuzikologji », Cikël leksionesh.
2. Ramadan Sokoli, « Folklori muzikor shqiptar », Tiranë, 1956
3. Vasil S. Tole, « Folklori muzikor : iso-polifonia dhe monodia », Uegen
4. Vasil S. Tole, «The Albanian Intangible Heritage in CD», Unesco, 2004, fq. 62.
5. Vasil S. Tole, «Odiseja dhe Sirenat, grishje drejt viseve iso-polifonike te Epirit», Uegen, 2005;
6. Vasil S. Tole, «Enciklopedia e Iso-polifonisë popullore shqiptare+CD», Uegen, 2007.
7. Vasil S. Tole, « Sprovë për një fjalës të muzikës popullore homofonike të Shqipërisë së Veriut », Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2010, fq. 146.
8. Vasil S. Tole, «Pse qanë kuajt e Akilit», Mediaprint, 2011, fq. 198.